



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

V E N D I M

Nr. 14, Datë 24/01/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 100, datë 09.07.2018, e Z. K. B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e Albpetrol sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se ankuesi ka filluar punë pranë Albpetrol sh.a. në datën 18.04.2014, në pozicionin e specialistit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, pozicion, në të cilin ka punuar deri në datën 04.01.2017, pasi në vijim është ngritur në detyrë dhe është emëruar në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve pranë Q.F.M.T Patos, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën **12.12.2017**. Më pas, Z. K.B. ka kaluar në pozicionin e specialistit në Sektorin e Prokurimeve pranë Q.F.M.T Patos, lëvizje, për të cilën ai thekson faktin se është bërë pa pëlqimin e tij, në kushtet e një presioni të madh politik, pasi ai është anëtar i forcës politike LSI.

¹Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në përforcim të idesë së diskriminimit për shkaqe politike, ankuesi deklaroi se në zgjedhjet kombëtare të zhvilluara në vitin 2017, ai ka qenë kandidat për deputet për Lëvizjen Socialiste për Integrim, si dhe është anëtar i Këshillit Bashkiak i qytetit të Fierit, për periudhën 2015-2019.

Ankuesi shprehet se presioni politik për të dhënë dorëheqjen nga pozicioni i tij i punës, ka qenë tepër i madh në muajin tetor 2017, periudhë në të cilën ai ka qenë i detyruar të bëjë kërkesë për dorëheqje nga pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve, pranë Q.F.M.T Patos, kërkesë të cilën nuk e ka protokolluar. Në datën 12.12.2017, kalimi i tij nga pozicioni i përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve në pozicionin e specialistit pranë të njëjtit Sektor, është kryer me Urdhër të Drejtorit të Q.F.M.T. Patos, Z. A.C.. Për këtë fakt, ankuesi shprehet se është në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore dhe Rregulloren e Albpetrol sh.a., pasi një gjë e tillë është tagër e Administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe jo e drejtorëve të qendrave të prodhimit dhe shërbimeve, të cilët nuk kanë kompetenca të tilla. Z. K. B. thekson faktin se trysnia nga ana e drejtuesit të Q.F.M.T. Patos, Z. A. C., për të dhënë dorëheqjen ka qenë tepër e madhe. Ankuesi pretendon se, në kushtet kur, ai nuk ka pranuar të japë dorëheqjen, në datën 21.12.2017, Administratori i Albpetrol sh.a. ka kërkuar kryerjen e auditimit për periudhën 01.01.2017-31.12.2017, mbi zbatimin e ligjshmërisë për prokurimet publike në Q.F.M.T. Patos.

Z. K. B. thekson se Albpetrol sh.a. ka ndërmarrë masa për ulje në detyrë apo largim nga puna të disa punonjësve, anëtarë apo simpatizantë të forcës politike LSI. Z. K. B. përmend si të tilla rastin e Z. E. Sh., Znj. V. J., Z. A. B., Z. A. H., Z. G. D. etj.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se i është ndryshuar pozicioni i punës për shkak të bindjeve të tij politike, të cilat janë të ndryshme nga ato të Administratorit të Albpetrol sh.a dhe Drejtuesit të Q.F.M.T. Patos.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

A. Pas kryerjes së procesit të plotësimit me dokumentacionin e nevojshëm të ankesës nr. 100, datë 09.07.2018, së Z. K. B., si dhe pas analizimit të saj paraprak, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Albpetrol sh.a., me shkresën nr. 963/1, datë 18.07.2018, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga ankuesi. Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe ankuesit.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 963/1, datë 18.07.2018, të KMD-së, Albpetrol sh.a. dërgoi shkresën nr. 6363/1, datë 01.08.2018, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se Z. K. B. është punonjës i Albpetrol sh.a. nga data 18.04.2014. Nga data 12.12.2017 mban pozicionin “*specialist prokurimi për blerjet e vogla*”, pranë Qendrës së Furnizimit dhe Transportit Patos (ish Q.F.M.T.). Gjatë vazhdimësisë së marrëdhënieve të punës me shoqërinë Albpetrol sh.a., Z. K. B. ka patur ndryshime të pozicionit të punës, me pëlqimin e tij paraprak dhe në bazë të dokumentacionit zyrtar rezulton se, ankuesi ka punuar fillimisht në pozicionin e specialistit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Administratës nga data 18.04.2014, deri në datën 30.12.2016. Në vijim, ankuesi ka kaluar në pozicionin e Përgjegjës të Njësisë së Prokurimeve për Blerjet e vogla, pozicion, të cilin e ka mbajtur gjatë periudhës 30.12.2016 – 12.12.2017. Nga data 12.12.2017 e në vijim, Z. K. B. ka punuar në pozicionin e specialistit të prokurimit për blerjet e vogla

Për sa më sipër, Albpetrol sh.a. thekson faktin se transferimi dhe ndryshimi i vendit të punës nga pozicioni “Përgjegjës i Njësisë së Prokurimeve për Blerjet e Vogla”, në pozicionin “specialist” pranë të njëjtës njësi, është kryer me marrëveshje të plotë midis palëve, si dhe mbështetur në kërkesën me shkrim të paraqitur nga Z. K. B.. Albpetrol sh.a., shprehet se në referencë të nenit 21, pika 1, të Kodit të Punës, kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë. Fakti që Z. K. B. ka paraqitur kërkesën e tij me shkrim për kalimin në pozicion tjetër pune, hedh poshtë çdo pretendim për diskriminim për shkak të përkatësisë partiake.

Kërkesa me shkrim e ankuesit për lirim nga detyra e Përgjegjës të Njësisë së Prokurimeve për Blerjet e Vogla dhe transferimin në pozicionin specialist pranë së njëjtës njësi, është përcjellë në rrugë zyrtare nga Q.F.M.T. Patos drejt Albpetrol sh.a. Shkresa në fjalë është sigluar nga Drejtori Teknik i Albpetrol sh.a., i cili ka patur autorizim nga Administratori i Shoqërisë për periudhën përkatëse. Ky siglim nënkupton se Drejtori Teknik, në cilësinë e personit të autorizuar nga

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Administratori i shoqërisë ka miratuar transferimin, mbështetur në kërkesën e Z. K. B.. Në këtë kuptim, ky transferim nuk është kryer nga Drejtori i Qendrës, i cili pretendohet se nuk ka tagër për këto lëvizje, por e gjithë praktika është konfirmuar nga Drejtori Teknik i Albpetrol sh.a. Albpetrol thekson faktin se pas momentit të transferimit, prej datës 12.12.2017 e në vijim, Z. K. B. ka vijuar punën normalisht, duke kryer detyrën e specialistit në Njësinë e Prokurimeve për Blerjet e Vogla dhe nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim mbi ndryshimin e pozicionit të punës. Kjo vërtetohet nga dokumenta të ndryshme të nënshkruara prej tij, të cilat dëshmojnë pranimin dhe ushtrimin e detyrës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit mbi auditimin e kryer pranë Q.F.M.T. Patos për periudhën 01.01.2017, deri më 31.12.2017, Albpetrol sh.a. sjell në vëmendje të KMD-së faktin se auditimi i veprimtarisë financiare të Shoqërisë, përfshirë këtu edhe auditimin e veprimtarisë së Njësisë së Prokurimeve për Blerjet e Vogla është pjesë e detyrave funksionale të Drejtorisë së Auditit dhe kryhet për çdo vit pune. Auditimi me objekt *“zbatimin e ligjshmërisë për prokurimet publike”* në Q.F.M.T. Patos është kryer periodikisht nga momenti i krijimit të Njësisë së Prokurimeve për blerjet e vogla e në vijim. Në këtë kontekst, Albpetrol sh.a. shprehet se është audituar gjithashtu edhe periudha kohore 01.01.2016 – 31.12.2016, periudhë në të cilën detyra e Përgjegjës të Njësisë së Prokurimeve për Blerjet e Vogla është kryer nga një punonjës tjetër dhe jo nga ankuesi.

Në shkresën e Albpetrol sh.a. përmendet fakti se gjatë kohës që Z. K. B. ka mbajtur pozicionin e punës specialist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Administratës, ndaj tij është marrë masa disiplinore *“vërejtje me shkrim me paralajmërim për pushim nga puna”*, dhënë me shkresën nr. 9235, datë 21.12.2015, e Albpetrol sh.a. Z. K. B. është njohur me masën dhe e ka pranuar. Ndërkohë që, për periudhën që ankuesi ka punuar në pozicionin *“Përgjegjës i Njësisë së Prokurimeve për Blerjet e Vogla”*, vlerësimet për veprimtarinë e Njësisë së prokurimeve janë shprehur në Raportin Përfundimtar të Drejtorisë së Auditit, mbi auditimin me objekt *“zbatimin e ligjshmërisë për prokurimet publike”* në Q.F.M.T. Patos.

2. Nëpërmjet e-mailit të datës 30.07.2018, ankuesi K. B. e informon Komisionerin, mbi faktin se në adresë të tij është dërguar shkresa nr.6339, datë 20.07.2018, e Albpetrol sh.a., nëpërmjet së cilës ankuesi njoftohet për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, për shkak të pushimit kolektiv. Në vijim, në datën 02.08.2018, Z. K. B. dërgon pranë KMD-së, në cilësinë e provës, ankesën drejtuar Komisionit të Vlerësimit të Ankesave të shoqërisë Albpetrol sh.a., ngritur për shqyrtimin e ankesave të punonjësve që prekeshin nga ristrukturimi i kësaj shoqërie.

3. Me shkresën nr. 936/2, datë 31.07.2018, drejtuar Albpetrol sh.a., Komisioneri e bën me dije Shoqërinë Albpetrol sh.a., se në referencë të nenit 15, pika 2³, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në asnjë rast institucionet publike apo subjektet private nuk mund të ndërpresin marrëdhëniet e punës me punonjësin, gjatë kohës që ankesa e tij është duke u shqyrtuar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Referuar informacionit të përcjellë nga ankuesi, Komisioneri kërkoi informacion me shkrim mbi situatën në fjalë, brenda datës 05.08.2018.
4. Në përgjigje të shkresës nr. 963/1, datë 18.07.2018, së Komisionerit, Albpetrol sh.a. dërgoi shkresën nr. 963/5, datë 20.08.2018, me anë të së cilës e bën me dije Komisionerin, se në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, i miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimeve nr. 496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria “Albpetrol” sh.a. është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore dhe për këtë arsye ka ndërmarrë hapat për nisjen e procedurave të pushimit kolektiv. Në kuadër të këtij procesi është nënshkruar Akt-Marrëveshja me Organizatën Sindikale, përfaqësuese të punëmarrësve, për përcaktimin e kriterëve, mbi të cilat do të kryhet procedura e pushimit kolektiv.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me Z. K. B., për shkak të punonjësve që janë të përfshirë në këtë proces, në referencë të nenit 148/1 të Kodit të Punës, nuk vlerësohet si pushim individual, por si pushim kolektiv. Kjo do të thotë se marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës, pra raporti ndërmjet shoqërisë “Albpetrol” sh.a dhe Z. K. B. nuk është aspak individual dhe i lidhur me pretendimin e tij, se është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me shoqërinë për shkak të ankesës që Z. K. B. ka bërë pranë Komisionerit. Fakti i pakundërshtueshëm është se në Qendrën e punës, në të cilën punon aktualisht Z. K. B., kanë filluar procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës edhe për punonjës të tjerë, të cilët janë prekur si rezultat i procesit të ristrukturimit dhe shkurtimit të vendit të punës. Në të gjithë shoqërinë “Albpetrol” sh.a. është duke u kryer një ristrukturim, i cili prek një numër të konsiderueshëm punonjësish, pra ndodhemi në rastin klasik të pushimit kolektiv, mbështetur në nenin 148 të Kodit të Punës. Në shkresën e Albpetrol sh.a. theksohet fakti, se Z. Bogdani nuk ka depozituar asnjë provë shkresore që është diskriminuar nga Albpetrol sh.a.

³ Neni 15, pika 2 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon: “Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.”

Ndër të tjera, Albpetrol sh.a. thekson faktin se në përmbushje të detyrimit ligjor që rrjedh nga neni 15, pika 2 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe shkresës nr. 963/2, datë 31.07.2018, të KMD-së, nuk do të ndërpresë marrëdhëniet e punës me ankesin, brenda afateve të përcaktuara nga Kodi i Punës, deri në momentin që KMD do të shprehet me vendim në lidhje me ankesën e Z. K. B..

5. Me e-mailin e datës 15.08.2018, ankuesi e njofton KMD-në, se në Analizën e Punës së 6-Mujorit të Parë të vitit 2018, të Albpetrol sh.a., reflektohet fakti se gjatë kësaj periudhe janë punësuar 79 punonjës të rinj pranë kësaj shoqërie. Në këtë kontekst, ankuesi shprehet, se ndërkohë që Albpetrol sh.a. është duke kryer pushim kolektiv të punonjësve ekzistues, në të njëjtën kohë emëron 79 punonjës të tjerë, të rinj.

C. Në vijim të procedurave hetimore për shqyrtimin e ankesës së Z. K. B., mbështetur në Urdhërin nr. 167, datë 12.09.2018, e KMD-së, në datën 20.09.2018, u krye inspektim pranë Albpetrol sh.a.

Objekti i inspektimit konsistonte në çështjet e mëposhtëme:

1. Informacion mbi numrin e emërimeve të reja të kryera pranë Albpetrol sh.a, gjatë tremujorit të dytë, të vitit 2018.
2. Sa nga punonjësit e emëruar gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2018 i janë nënshtruar pushimit kolektiv. Të administrohet lista e punonjësve në fjalë, e cila të përmbajë datat e emërimit dhe largimit nga puna;
3. Kopje e Aktmarrëveshjes së Albpetrol sh.a. me Organizatën Sindikale të punonjësve të kësaj shoqërie, lidhur me përcaktimin e kriterëve mbi të cilat është kryer procesi i pushimit kolektiv.
4. Numri i punonjësve pranë Qendres dhe Furnizimit dhe Transportit (QFT) Patos, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna.
5. Numri i punonjësve të Njësisë së Prokurimeve pranë QFT Patos, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv.
6. Kopje e strukturës aktuale dhe strukturës së mëparshme të Qendres dhe Furnizimit dhe Transportit (QFT) Patos;
7. Kopje e Urdhërit nr. 63, datë 16.07.2018 dhe Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a.
8. Përgjigja zyrtare e Albpetrol sh.a. mbi ankesën e Z. K. B., datë 31.07.2018, lidhur me kriteret e përcaktuara në pikëzimin për shkurtimin e fuqisë punëtore.

9. Kërkesa me shkrim e Z. K. B., nëpërmjet së cilës ai ka kërkuar të lirohet nga detyra e përgjegjësit të Sektorit të prokurimeve pranë Qendrës dhe Furnizimit dhe Transportit (QFT) Patos;
10. Informacion mbi faktin nëse Z. K. B. ka depozituar ankesë pranë Albpetrol sh.a., lidhur me transferimin e tij, nga Përgjegjës në specialist pranë Sektorit të Prokurimeve, pranë Qendrës dhe Furnizimit dhe Transportit (QFT) Patos;
11. Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen në fjalë.

Gjatë kryerjes së inspektimit pranë Albpetrol sh.a. në lidhje me kryerjen e verifikimeve të pretendimeve të Z. K. B., inspektorët e Komisionerit morën informacionin përkatës për çështjet që përbënin objektin e urdhërit të inspektimit.

Lidhur me pikën e parë të objektit të inspektimit, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se Analiza 6-Mujorit të Parë të Punës së Shoqërisë nuk është miratuar ende në Këshillin Mbikqyrës të Shoqërisë. U ra dakord që versioni përfundimtar i Analizës së Punës për 6-Mujorin e Parë të Vitit 2018, nënshkruar nga Këshilli Mbikqyrës i Albpetrol sh.a., të dërgohej zyrtarisht pranë Komisionerit.

Lidhur me pikën e dytë, të objektit të inspektimit, inspektorët u sqaruan se gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2018, pranë Albpetrol sh.a. janë kryer 5 emërimet e reja, pranë Q.N.P. Gorisht. Punonjësit e emëruar mbajnë pozicionet e punës “teknik naftë”, “axhustator”, “saldator” etj.

Lidhur me pikën e tretë, të objektit të inspektimit, inspektorët e KMD-së morën në administrim një kopje të Aktmarrëveshjes së Albpetrol sh.a. me Organizatën Sindikale të punonjësve të kësaj shoqërie, lidhur me përcaktimin e kriterëve mbi të cilat është kryer procesi i pushimit kolektiv.

Lidhur me pikën 4 të objektit të inspektimit, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se 13 (trembëdhjetë) punonjës të Q.F.T. Patos i janë nënshtruar pushimit kolektiv.

Lidhur me pikën 5 të objektit të inspektimit, rezulton se numri i punonjësve të Njesisë së Prokurimit të Blerjeve të Vogla pranë Q.F.T. Patos, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv është 2 specialistë. Aktualisht, kjo Njësi funksionon sipas organikës: *1 përgjegjës njësie dhe 2 specialistë*. Proçesverbalet përkatëse mbi vlerësimin sipas pikëzimit të 4 specialistëve të Njesisë së Prokurimit për Blerjet e Vogla pranë Q.F.T. Patos, u ra dakord, që do të dërgohen në vijim, me shkresë zyrtare pranë KMD-së.

Lidhur me pikat 6, 7 dhe 9 të objektit të inspektimit, inspektorët e KMD-së morën në administrim kopje të strukturës aktuale dhe strukturës së mëparshme të Qendrës dhe Furnizimit dhe

Transportit (QFT) Patos, si dhe kopje të Urdhërit nr. 63, datë 16.07.2018 dhe Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a.

Lidhur me informacion e kërkuar në pikat 8 dhe 10 të objektit të urdhërit të inspektimit, u ra dakord qe Albpetrol sh.a. t'i dërgojë në ditët në vijim me shkresë zyrtare në adresë të KMD-së, pasi informacioni i kërkuar nuk ishte përgatitur.

D. Ndërkohë, me e-mailin e datës 01.10.2018, ankuesi K. B. e informon KMD-në, se nëpërmjet Vendimit nr. 730, datë 01.10.2018, të Albpetrol sh.a., atij i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, për shkak të ristrukturimit organizativ të Shoqërisë.

E. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 1328, datë 26.09.2018 “*Njoftim për seancë dëgjimore*”, KMD iu drejtua Administratorit të Albpetrol sh.a. dhe ankuesit K. B., duke i njoftuar për pjesëmarrje në seancën dëgjimore, që u zhvillua në datën 04.10.2018, pranë Zyrës së Komisionerit.

Përfaqësuesit (me autorizim) të Albpetrol sh.a. u njoftuan gjithashtu për të paraqitur në këtë seancë, informacionin dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Proçesverbalet përkatëse mbi kryerjen e vlerësimit me pikëzim të të gjithë specialistëve të Njesisë së Prokurimeve pranë Q.F.M.T., Patos, si dhe kopje të dosjeve të tyre personale;
2. Informacion, nëse ankuesi ka depozituar ankesë pranë Albpetrol sh.a., lidhur me transferimin e tij, nga pozicioni “Përgjegjës Sektori”, në pozicionin “Specialist”, pranë Njesisë së Prokurimeve së Q.F.M.T., Patos;
3. Përgjigja zyrtare e Albpetrol sh.a. drejtuar ankesës me shkrim të Z. K. B., datë 31.07.2018;
4. Struktura e mëparëshme dhe struktura aktuale e Albpetrol sh.a., ku të përfshihen edhe qendrat e kësaj shoqërie.
5. Analiza 6-mujore e punës së Shoqërisë “Albpetrol” sh.a., miratuar nga Administratori dhe Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë;
6. Numri i punonjësve të emëruar nga Albpetrol sh.a nga data **01.01.2018-01.06.2018**, duke specifikuar pozicionet përkatëse të punës dhe datat e emërimit të tyre.
7. Numri i punonjësve të Albpetrol sh.a, që janë emëruar në periudhën e mësipërme, të cilët i janë nënshtruar pushimit kolektiv, në kuadër të ristrukturimit të shoqërisë;
8. Prova të tjera që Albpetrol sh.a disponon, lidhur me pretendimet e ankuesit.

Gjatë seancës dëgjimore, palët në proçes paraqiten edhe një herë pretendimet dhe prapësimet e tyre lidhur me dy momentet me karakter diskriminues, të pretenduara nga ankuesi.

Lidhur me momentin e parë, i cili konsistonte në uljen në detyrë të ankuesit nga pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve, në pozicionin e specialistit pranë Q.F.M.T., Patos, Z. K. B. u shpreh se kjo lëvizje nuk është kryer me dëshirën dhe vullnetin e tij. Kërkesa e tij për ndryshim të pozicionit të punës nuk është e protokolluar. Ankuesi thekson faktin se ka paraqitur ankesë pranë Albpetrol sh.a., ku kundërshton ndryshimin e pozicionit të tij të punës. I pyetur nga Komisioneri, nëse e ka kundërshtuar gjyqësisht ndryshimin e pozicionit të tij të punës, ankuesi u shpreh se nuk e ka bërë një gjë të tillë, por ka vazhduar të punojë në pozicionin të ri të punës. Njëkohësisht, ndryshimi i pozicionit të tij të punës nga Përgjegjës Sektori, në Specialist pranë Njësisë së Prokurimeve është kryer me Urdhër të Drejtorit të Qendrës, fakt që bie në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme dhe Statutin e Shoqërisë Albpetrol sh.a., pasi emërimi dhe shkarkimi i punonjësve të shoqërisë është tagër e Administratorit të Shoqërisë dhe jo e drejtorëve të qendrave. Ndërkohë që, për këtë çështje, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. theksuan faktin se Z. K. B. ka depozituar kërkesë për ndryshimin e pozicionit të punës nga Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve në specialist pranë të njëjtit sektor. Ndryshimi i pozicionit të punës është kryer në marrëveshje ndërmjet palëve dhe Z. K. B. nuk e ka kundërshtuar gjyqësisht kalimin e tij në një pozicion më të ulët, por ka vijuar punën në pozicionin e ri. Lidhur me pretendimin e Z. K. B., se Drejtori i Qendrës nuk ka tagër për të kryer lëvizje të punonjësve, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se Administratori i Shoqërisë ka lëshuar Autorizim të Posaçëm, nëpërmjet së cilit drejtorët e qendrave në varësi të Albpetrol sh.a. autorizohen për të kryer veprime të tilla. Për sa më sipër, u ra dakord që një autorizim i tillë do të depozitohet në cilësinë e provës, pranë KMD-së në ditët në vijim. Në seancën dëgjimore, ankuesit iu kërkua të provonte presionin, që ishte ushtruar ndaj tij për të dhënë dorëheqjen nga pozicioni i tij i punës. Në këtë kontekst, Z. K. B. iu kërkua nëse dispononte e-maile, apo akte shkresore, nëpërmjet së cilave reflektohej trysnia e ushtruar ndaj tij për të dhënë dorëheqjen dhe presioni ndaj të cilit ai pretendonte se ishte përballur, në periudhën kur punonte në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve pranë Q.F.M.T., Patos. Ankuesi u shpreh se nuk dispononte prova të tilla.

Lidhur me momentin e dytë, për të cilin ankuesi pretendon diskriminim për shkak të bindjes politike, i cili ka lidhje me përfshirjen e tij në pushimin kolektiv, që ka zbatuar Albpetrol sh.a., përfaqësuesit e kësaj shoqërie u shprehën se rreth 450 punonjës të saj i janë nënshtruar pushimit kolektiv. Për rastin e Z. K. B., ata theksuan faktin se Sektori i Prokurimeve pranë Q.F.M.T., Patos ka patur në përbërje të tij një Përgjegjës Sektori dhe 4 specialistë. Me miratimin e strukturës së re, të kësaj qendre, pranë Sektorit të Prokurimeve duhet të punonin 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 2 (dy) specialistë. Pas kryerjes së vlerësimit me pikëzim të 4 specialistëve nga Komisioni i Vlerësimit, i ngritur me Urdhër të Administratorit pranë kësaj qendre, rezultoi se të katër specialistët dolën me pikë të barabarta (50 pikë). Në këto kushte, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a., u shprehën se mbështetur në performancën e tyre në punë, u përzgjedhën 2 specialistë që do të qëndronin në marrëdhënie

punë me këtë shoqëri dhe 2 të tjerë, të cilët duhet t'i nënshtroheshin pushimit kolektiv. Të pyetur nëse Albpetrol sh.a. kryen vlerësime në punë të punonjësve të tij, përfaqësuesit e kësaj shoqërie u shprehën se këtë vit kishte filluar praktika e vlerësimit të performancës në punë. Komisioneri kërkoi prova konkrete, se ku është mbështetur Albpetrol sh.a. për të kryer përzgjedhjen e specialistëve në Sektorin e Prokurimit pranë Q.F.M.T., Patos, por përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se një gjë e tillë është në diskrecion të Administratorit të Albpetrol sh.a., si dhe është marrë në konsideratë ecuria e kryerjes së detyrave nga ankuesi apo kryerja e procedurave të prokurimit nga ana e tij. Në seancë u bë i ditur fakti se Z. K. Ç. i cili fillimisht iu nënshtroa pushimit kolektiv sikurse ankuesi, aktualisht ishte sistemuar në një pozicion tjetër punë pranë Shoqërisë "Albpetrol" sh.a. Përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. sqaruan se Z. K. Ç. është sistemuar, pasi u krijua një vend vakant dhe ai ka paraqitur kërkesë për sistemim në punë. I pyetur nga KMD, nëse kërkon të ri-sistemohet në punë pranë Albpetrol sh.a., ankuesi K. B. shprehet se është dakord. Njëkohësisht, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. theksuan faktin se përfshirja e Z. K. B. në pushimin kolektiv, nuk ka aspak lidhje me bindjet e tij politike apo përkatësinë e tij në forcën politike LSI, pasi njëra prej specialisteve që ka qendruar në punë në Sektorin e Prokurimeve të Q.F.M.T., Patos, pas kryerjes së vlerësimit me pikëzim nga komisioni përkatës, përkatësisht specialistja V.M. është anëtare e LSI. Njëkohësisht, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se ka patur shumë ankesa nga ish-punonjës të kësaj shoqërie, të cilët i janë nënshtroar pushimit kolektiv edhe pse kanë qenë anëtarë apo simpatizantë të Partisë Socialiste. Në këtë kontekst, ata paraqitën ankesa të tilla në cilësinë e provës.

Lidhur me të dhënat e depozituara nga ankuesi pranë KMD-së, ku sipas analizës 6-mujore të Shoqërisë Albpetrol sh.a. rezultoi se janë kryer rreth 79 punësime të reja, ndërkohë që punonjësit ekzistues i janë nënshtroar pushimit kolektiv, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se dokumenti i Analizës 6 mujore të Shoqërisë nuk është miratuar ende nga Këshilli Mbikqyrës dhe në këto kushte nuk ka marrë formë përfundimtare. Pavarësisht kësaj, mbështetur në kërkesën e KMD-së ata depozituar listën e punonjësve të rinj të emëruar gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2018, si dhe të punonjësve të rinj, të cilët i janë nënshtroar pushimit kolektiv.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesve të Albpetrol sh.a. iu vu në dukje fakti, mbi çështjen e daljes të vendimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me Z. K. B., edhe pse ankesa e këtij të fundit ishte ende duke u shqyrtuar nga KMD dhe aq më tepër kur Albpetrol sh.a. ishte informuar zyrtarisht nga Komisioneri mbi një fakt të tillë dhe kjo shoqëri kishte dhënë konfirmimin e saj për sa më sipër.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ankuesi K. B. ka filluar punë pranë Albpetrol sh.a. në datën 18.04.2014, në pozicionin e specialistit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, nëpërmjet kontratës individuale të punës Nr. prot. 3486, datë 18.04.2014, të lidhur ndërmjet tij dhe punëdhënësit të tij, Shoqërisë Albpetrol sh.a., përfaqësuar nga Administratori i kësaj Shoqërie, Z. E. P. Ankuesi ka punuar në pozicionin e sipërpërmendur, deri në datën 04.01.2017, pasi në vijim nëpërmjet shkresës nr. 8472, datë 30.12.2016, së Administratorit të shoqërisë, Z. K. B. është ngritur në detyrë dhe është transferuar në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve pranë Q.F.M.T Patos. Ankuesi ka punuar në këtë detyrë deri në datën 12.12.2017, ku nëpërmjet Urdhërit të Brendshëm nr. 1003, datë 12.12.2017, të Drejtorit të Q.F.M.T Patos, ai ka kaluar në pozicionin e specialistit në Sektorin e Prokurimeve pranë Q.F.M.T Patos, lëvizje, për të cilën ai thekson se është bërë pa pëlqimin e tij dhe në kushtet e një presioni të madh politik, pasi ai është anëtar i forcës politike LSI, si dhe anëtar e përfaqësues i kësaj forcë politike në Këshillin Bashkiak Fier. Pas depozitimit të ankesës së tij pranë KMD-së, Z. K. B. njoftohet nëpërmjet shkresës nr.6339, datë 20.07.2018, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv. Në vijim, ankuesi merr dijeneri mbi Vendimin nr. 730, datë 01.10.2018, e Administratorit të shoqërisë, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit organizativ të Albpetrol sh.a.

A/1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesi, lidhur me kalimin në një pozicion pune hierarkisht më të ulët.

Pretendimi i Z. K. B. për diskriminim i ka fillesat e tij në momentin e kalimit të tij nga “Përgjegjës Sektori” pranë Sektorit të Prokurimeve, të Q.F.M.T., Patos ku kishte punuar për pothuaj 1 vit, në pozicionin e “specialistit” pranë të njëjtit sektor. Për sa më sipër, Albpetrol sh.a. shprehet se ankuesi ka nënshkruar një kërkesë me shkrim, nëpërmjet së cilës ai kërkon të ndryshojë pozicionin e punës. Ankuesi nuk e mohon faktin se kërkesa është shkruajtur nga ana e tij, por shprehet se kjo kërkesë është e paprotokolluar dhe si e tillë nuk mund të merrej për bazë për ta transferuar në një pozicion tjetër pune. Z. K. B. shprehet se ka qenë nën një presion dhe trysni tepër të madhe nga eprorët e tij për të dhënë dorëheqjen, por një gjë e tillë nuk është e provuar nga ankuesi para Komisionerit, pasi nuk ekzistojnë prova konkrete, të cilat të vërtetojnë një fakt të tillë. Ankuesi ka paraqitur në cilësinë e provës ankesën nr. 450 Prot., date 05.07.2018,

drejtuar Administratorit të Albpetrol, ku kundërshton ndryshimin e pozicionit të tij të punës dhe thekson faktin, se kërkesa për dorëheqje është e paprotokolluar dhe nuk i drejtohet asnjë prej titullarëve të Albpetrol sh.a. Në përgjigje të kësaj ankese, Albpetrol sh.a. nuk ka reaguar dhe nuk ka kthyer përgjigje. Përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u informuan mbi këtë ankesë të ankuesit në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 04.10.2018 dhe Komisioneri u kërkoi që të kryheshin verifikimet përkatëse lidhur me të, por pavarësisht kësaj kjo shoqëri nuk dërgoi asnjë përgjigje lidhur me verifikimet e kryera.

Për sa më sipër, mbështetur në kërkesën me shkrim të ankuesit, Z. E. SH., Drejtor i Q.F.M.T Patos i është drejtuar Administratorit të Albpetrol sh.a., me anë të shkresës nr. 787, datë 02.10.2017, ku i kërkohet të kryhet zëvendësimi i Z. K. B. me Z. H. Gj., i cili në atë kohë punonte në pozicionin e specialistit pranë Sektorit të Prokurimeve. Në vijim, me Urdhërin e Brendshëm nr. 50, datë 12.12.2017, të Drejtuesit të Q.F.M.T., Patos, ankuesi lirohet nga pozicioni i punës “përgjegjës sektori” dhe kalon në pozicionin “specialist” pranë të njëjtit sektor. Nëpërmjet të njëjtit urdhër, në pozicionin “përgjegjës sektori” është emëruar Z. H.GJ. Ankuesi pretendon se drejtori i qendrës nuk ka asnjë tagër për të kryer emërim apo për të kryer ndryshime të pozicioneve të punës së punonjësve të tij, pasi kjo është tagër dhe kompetencë e Administratorit të Shoqërisë. Albpetrol sh.a. ka theksuar faktin se Drejtori i qendrës ka qenë i autorizuar nga Administratori i Shoqërisë për të kryer veprime të tilla dhe ka depozituar në cilësinë e provës Autorizimin Nr. Extra Prot., datë 05.01.2014, të Administratorit të Albpetrol sh.a. Për sa më sipër, Komisioneri konstatoi se në këtë Autorizim përcaktohet shprehimisht: *“Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të shoqërisë “Albpetrol sh.a. autorizohen Drejtorët e Qendrave në varësi të shoqërisë Albpetrol sh.a. të japin masa disiplinore ndaj punonjësve në rast të kryerjes së shkeljeve disiplinore, mbështetur në Kontratën Individuale të Punës si dhe në Kodin e Punës”*. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Drejtuesi i Q.F.M.T Patos ka qenë i legjitimuar në të drejtën e tij për dhënie masash disiplinore ndaj punonjësve në varësi të tij, por jo për të kryer ndryshime në pozicionet e punës së tyre, sidomos kur këto të fundit janë ulje në detyrë. Z. K. B. nuk i ishte dhënë masë disiplinore, e cila të parashikonte si masë të marrë ndaj tij uljen në detyrë, fakt që mund të justifikonte dhe të legjitimonte daljen e Urdhërit të Brendshëm nr. 50, datë 12.12.2017, të Drejtuesit të Q.F.M.T., Patos.

Komisioneri konstatoi gjithashtu se kërkesa me shkrim e Z. K. B., nëpërmjet së cilës kërkohet lirimi nga detyra e Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimeve dhe transferimi i tij në specialist pranë të njëjtit sektor nuk përmban: (1) datën e paraqitjes të saj, (2) titullarin të cilit i drejtohet, si dhe (3) numër dhe datë protokollit të Q.F.M.T Patos/Albpetrol sh.a. Në këto kushte, KMD gjykon se kjo kërkesë me shkrim nuk përmbush kriteret formale për t’u marrë në konsideratë, si një kërkesë e mirëfilltë për dorëheqje. Njëkohësisht, Drejtuesi i Qendrës ka nxjerrë një akt administrativ, për

të cilin nuk ka asnjë kompetencë, pasi kjo e fundit i takon Administratorit të Shoqërisë, në bazë të Statutit dhe Rregullores së Brendshme të Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Autorizimi nr. Extra Prot., datë 05.01.2014, i Administratorit të Albpetrol sh.a. nuk e legjitimon drejtuesin e Q.F.M.T Patos të kryejë transferime të punonjësve.

Në këto kushte, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se ankuesi K. B. është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a.

A/2. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesi, lidhur me përfshirjen e saj në pushimin kolektiv nga puna, të ndërmarrë në kuadër të zbatimit të ristrukturimit të Albpetrol sh.a.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës nr. 100, datë 09.07.2018, e Z. K. B., rezulton se mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018, e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpetrol sh.a.i është nështruar procesit të ristrukturimit të saj, si rrjedhim i së cilit rezulton se i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesore të Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018. Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“1.Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë nënshtruar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450 të tillë, duke u konsideruar një pushim kolektiv me përmasa të konsiderueshme.

Në pikën 2, të Vendimit nr.496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018” parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njësisë të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2,3,4,5,6.”*

Në pikën 2, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si

dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3 të vendimit në fjalë miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a.me përbërje 3 (tre) Qendra të Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1,828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave.

Në kushtet kur fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive⁴ për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë që të përcaktoheshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t’u nënshtroheshin punonjësit e kësaj shoqërie të cilët do t’i nënshtroheshin pushimit kolektiv në punë.

Në bazë të Akt-Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., si dhe Shtojcës 1 në vijim të kësaj Akt-Marrëveshjeje, kriteret të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) Vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol sh.a., vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t’i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit, që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkërtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a. miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishme, lidhur me mënyrën, se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, e Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, e Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1 e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, të Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do

⁴ Kontrata Kolektive e Punës nr. 8781, datë 29.12.2017, lidhur ndërmjet Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH).

të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., lidhur me procedurën e kontrollit dhe administrimit të procesit të ankimimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Albpetrol sh.a. iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të tij, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e komisioneve të vlerësimit të ngritura në çdo qendër.

Në referencë të Vendimit nr.14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Albpetrol sh.a., “*Mbi programin e zhvillimit ekonomik të rishikuar për vitin 2018*”, pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë, numri i përgjithshëm i punonjësve të Q.F.M.T Patos është reduktuar me 12 punonjës, në krahasim me numrin e mëparshëm të punonjësve që punonin pranë kësaj qendre. Referuar organikës aktuale të Q.F.M.T Patos⁵, rezulton se njësia e prokurimeve për blerjet e vogla që bën pjesë në Sektorin e Furnizimit Materialo-Teknikë, ka në përbërje të saj 1 (një) përgjegjës sektori dhe 2 (dy) specialistë. Për sa më sipër, numri i specialistëve të kësaj njësie është ulur, nga 4 specialistë prokurimesh, që bënin pjesë në këtë njësi me strukturën e mëparshme⁶, në 2 të tillë. Z. K. B. punonte në njërin prej pozicioneve të punës “*specialist i prokurimit të blerjeve të vogla*” pranë kësaj Qendre.

Në referencë të përcaktimeve të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcës nr.1, e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri, Komisioni i vlerësimit pranë kësaj qendre ka vlerësuar me pikëzim 4 (katër) specialistët e Q.F.M.T, Patos. Sikurse është përmendur edhe më sipër, kriteret mbi të cilat u krye vlerësimi me pikëzim, sipas urdhërit të sipërpërmendur ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Mbështetur në këto kritere, duke iu referuar Proçesverbalit Përfundimtar nr. 454, datë 04.07.2018, rezulton se të katër specialistët e njësisë së prokurimit janë vlerësuar me nga 60 pikë secili. Në kushtet kur vlerësimi i tyre me pikëzim ka qenë i njëjtë, Komisioni i Vlerësimit, me qëllim kryerjen e përzgjedhjes së 2 (dy) prej tyre ka marrë parasysh performancën e tyre në punë.

Referuar Dispozitës së Fundit të Shtojcës 1, të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a. përcaktohet: “*Në kryerjen e procesit të vlerësimit dhe*

⁵ Referuar shkresës nr. 5533/7, datë 02.07.2018, së Administratorit të “Albpetrol” sh.a. drejtuar Q.F.M.T., Patos.

⁶Referuar shkresës nr. 4990, datë 21.07.2017, së Administratorit të “Albpetrol” sh.a. drejtuar Q.T. Patos dhe Q.A.R.P., Patos.

pikëzimit, Komisioni për të përzgjedhur punonjësit që preken nga procesi i ristrukturimit organizativ dhe të fuqisë punëtore, pavarësisht klasifikimit të mësipërm, do të marrë në konsideratë edhe treguesit e mëposhtëm të performancës në punë:

- *Masat disiplinore që rezultojnë për atë punonjës;*
- *Vlerësimi i treguesve në punë.”*

Mbështetur në sa më sipër, në Proçesverbalin Përfundimtar nr. 454, datë 04.07.2018, të vlerësimit të 4 specialistëve të Njësisë së Prokurimit pranë Q.F.M.T. Patos, citohet: “Në përfundim Komisioni vendos që punonjësit që konkuruan për vende pune Spec/prokurimeve, punonjësit me performancë më të dobët janë: K. C., K. B....”

Njëkohësisht, duke iu referuar proçesverbalit individual të vlerësimit me pikëzim të K. B., citohet: “Nga të dhënat për vlerësimin e treguesve në punë rezulton se punonjësi s’ka performancë të mirë në punë”. Ndërkohë që, në të njëjtin proçesverbal rezulton të jetë shënuar se nga të dhënat e dosjes së paraqitur për vlerësim rezulton se punonjësi nuk ka masa disiplinore⁷. Të njëjtat citime rezultojnë të jenë bërë edhe për specialistin K.C.

Në Dispozitën e Fundit të Shtojcës 1, të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a. nuk përcaktohet se cilët janë “treguesit në punë” dhe si kryhet vlerësimi i këtyre treguesve nga strukturat përkatëse të Albpetrol sh.a.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 04.10.2014, Komisioneri kërkoi të dispononte informacion, lidhur me performancën në punë të K. B. dhe mbi vlerësimet që i janë bërë këtij punonjësi nga eprorët e tij, por përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën se nuk ka patur vlerësime në punë të punonjësve gjatë viteve të mëparshme⁸, por këtë vit ishte filluar të proçedohet me vlerësimin e punonjësve të Albpetrol sh.a. Në vijim të seancës dëgjimore, Albpetrol sh.a. nuk depozitoi prova të tjera pranë Komisionerit, ku të evidentohet performanca në punë e ankuesit, apo vlerësimi i treguesve në punë, sikurse përcaktohet në urdhërin e sipërpërmendur, në kushtet kur referuar proçesverbalit të vlerësimit me pikëzim, performanca e ankuesit është cilësuar jo e mirë dhe është bërë shkak për skualifikimin e tij.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri gjykon se përzgjedhja e kryer nga Komisioni i Vlerësimit, duke u mbështetur në kriterin e performancës në punë të 4 (katër) specialistëve nuk

⁷ Z. K. B. nuk ka patur masa disiplinore gjatë periudhës kohore që ka punuar në Njësinë e Prokurimeve, pranë Q.F.M.T Patos, por ka patur një masë disiplinore të parashkruar, kur ka punuar në pozicionin specialist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore pranë Albpetrol sh.a.

⁸ Një fakt i tillë u bë i ditur nga strukturat përgjegjëse të Albpetrol sh.a. edhe gjatë inspektimit të kryer në këtë shoqëri, që u krye për kryerjen e verifikimeve të pretendimeve të ankuesit.

ka qenë korrekte, për sa kohë nuk ka tregues të evidentuar qartë të kësaj performancë në punë. Në mungesë të masave disiplinore dhe në mungesë të një vlerësimi të qartë të punës së secilit specialist të njësisë së prokurimit, ka qenë e pamundur përzgjedhja e tyre duke u mbështetur në kriterin e “*performancës në punë*”. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Z. K. B. është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a..

E njëjta procedurë u ndoq edhe për specialistin K.C., i cili u përzgjedh si jo fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Q.F.M.T. Patos, por në vijim për këtë punonjës procedura e pushimit nga puna u ndërpre, pasi ai u sistemua në një pozicion tjetër punë pranë kësaj shoqërie⁹. Një fakt i tillë është tregues i qartë për një trajtim jo të barabartë të ankuesit me persona, që janë në situatë të njëjtë me të, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

Për sa më sipër, nga analiza e sipërpërmendur, Komisioneri gjykon se ankuesi K. B. i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Albpetrol sh.a., në krahasim me punonjës të tjerë që ndodheshin në kushte të njëjta apo të ngjashme me të. Ky trajtim ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e kryerjes e përzgjedhjes së specialistëve të njësisë së prokurimit pranë Q.F.M.T. Patos, të cilët do t’i nënshtroheshin pushimit kolektiv, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ngritur pranë kësaj qendre, si dhe duke u mbështetur në trajtimin e pabarabartë që Albpetrol sh.a. e ka ekspozuar ankuesin në krahasim me Z. K.C, i cili aktualisht është i sistemuar në punë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 100, datë 09.07.2018, e Z. K. B., pretendohet diskriminim, për shkak të bindjeve politike¹⁰, nga ana e Albpetrol sh.a.

“Bindja politike”, “është njëri prej shkaqeve, për të cilët, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë

⁹ Përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. u shprehën në seancë dëgjimore se Z. K.C. kishte bërë kërkesë për t’u risistemuar në punë pranë kësaj shoqërie. Për këtë arsye, ai ishte ri-punësuar në një pozicion tjetër punë pranë shoqërisë. Albpetrol sh.a. nuk ka depozituar në cilësinë e provës pranë KMD-së, në vijim të seancës dëgjimore, asnjë kopje të kërkesës së Z. K. C. drejtuar kësaj shoqërie.

¹⁰ Referuar kartës së anëtarësisë nr. 27335, lëshuar në datën 09.10.2016, nga Lëvizja Socialiste për Integrim, si dhe dokumentacionit të dorëzuar në cilësi prove nga ankuesi.

prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “*bindja politike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

C/1. Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se Z. K. B. i është nënshtruar një qendrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a., pasi ulja e tij në detyrë ka qenë e pambështetur në një kërkesë formale me shkrim për dorëheqje, si dhe kjo lëvizje është kryer zyrtarisht nga Drejtori i Q.F.M.T. Patos, i cili nuk ka tagër dhe nuk ka qenë i autorizuar nga Administratori të nxjerrë akte të tilla.

Komisioneri gjykon se qendrimi i mbajtur nga ana e Albpetrol sh.a. ndaj Z. K. B. ka qenë tendencioz dhe është shprehur hapur në dy momentet e mësipërme. Pavarësisht faktit se gjatë shqyrtimit administrativ të kësaj ankese, Z. K. B. nuk ka arritur të japë prova konkrete, nëpërmjet së cilave të vërtetohej fakti se ndaj tij është ushtruar trysni dhe presion psikologjik, për të dhënë dorëheqjen nga pozicioni i Përgjegjës të Njësisë së Prokurimit, pranë Q.F.M.T Patos, veprimet e sipërpërmendura të kryera nga Albpetrol sh.a. krijojnë bindjen se veprimet ndaj ankuesit janë të qëllimta.

Mbështetur në analizën e mësipërme, Komisioneri gjykon se ndërmjet qendrimit të padrejtë dhe disfavorizues, ndaj të cilit Z. K. B. është ekspozuar nga ana e Albpetrol sh.a. dhe shkakut të diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, që është një shkak i mbrojtur ligjërisht, sikurse edhe me fakte e prova konkrete, ekziston një lidhje shkakësore. Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti se gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, Albpetrol sh.a. nuk paraqiti pranë Komisionerit fakte konkrete, që të provonin që ulja në detyrë e ankuesit ishte kryer mbi baza të ligjshme, objektive dhe të arsyeshme, si dhe të argumentohej e justifikohej bindshëm e kundërta e asaj që pretendohet nga Z. K. B.. Për sa më sipër, Komisioneri përgjatë hetimit dhe analizimit të provave konkrete ka krijuar bindjen që ky trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i Albpetrol sh.a. është i lidhur drejtpërdrejtë me bindjen politike të ankuesit.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ulja në detyrë e ankuesit K. B., pranë Q.F.M.T. Patos, është kryer për shkak të bindjes së tij, politike.

C/2 Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se ankuesi i është nënshtruar një procesi përzgjedhjeje, të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, nga ana e Komisionit të Vlerësimit, pranë Q.F.M.T Patos, gjë që ka sjellë si pasojë përfshirjen e ankuesit në pushimin kolektiv të kryer nga shoqëria, në kuadër të zbatimit të ristrukturimit të saj. Pavarësisht se të 4 (katër) specialistët e kësaj njësie fillimisht janë vlerësuar me pikë të njëjta, në bazë të kriterëve bazë të përcaktuara në Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcës nr.1, e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri, Komisioni i Vlerësimit ka marrë në konsideratë si kriter vlerësimi të mëtejshëm performancën e tyre në punë, nëpërmjet së cilës ka seleksionuar apo përzgjedhur të 2 (dy) specialistët që do t'i nënshtroheshin pushimit kolektiv. Gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se performanca në punë e punonjësve të Njesisë së Prokurimeve pranë Q.F.M.T. Patos nuk është e dokumentuar dhe nuk ka indikatorë konkretë, të përcaktuar qartë në një akt të miratuar nga Albpetrol sh.a., që të mund të orientojnë drejt një performancë në punë të punonjësit. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se vlerësimi i treguesve në punë ose performanca në punë nuk është e verifikueshme, si dhe rezulton e paprovuar dhe e pambështetur, për sa kohë që Albpetrol sh.a. nuk ka kryer asnjëherë vlerësim të performancës në punë të punonjësve të tij.

Shoqëria Albpetrol sh.a. nuk ka depozituar asnjë provë konkrete, që të vërtetojë performancën në punë të Z. K. B., gjatë periudhës kohore që ka punuar pranë Njesisë së Prokurimeve të Q.F.M.T. Patos. Njëkohësisht, ankuesi është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me kolegun e tij, Z. K. C., i cili sikurse Z. K. B., fillimisht iu nënshtrua pushimit kolektiv, pasi u përzgjedh si i tillë nga ana e Komisionit të Vlerësimit, e në vijim procedura e pushimit nga puna u ndërpre dhe ai u sistemua sërisht në punë pranë Albpetrol sh.a.

Por në vijim, në kushtet kur, në referencë të nenit 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”¹¹, kjo shoqëri ka patur barrën e provës

¹¹ Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

për të vërtetuar se ky përfshirja e Z. K. B., në pushimin kolektiv, nuk është kryer për shkaqe politike, Albpetrol sh.a. ka paraqitur prova, nëpërmjet së cilave kërkon të rrëzojë pretendimin e ankuesit.

Për sa më sipër, Albpetrol sh.a. ka theksuar faktin se gjatë procesit të ristrukturimit të “Albpetrol” sh.a., i janë nënshtruar pushimit kolektiv në punë rreth 450 punonjës të kësaj shoqërie dhe specifikisht 12 punonjës, pranë Q.F.M.T. Patos. Proçesi i ristrukturimit të shoqërisë është një proces madhor, i cili ka lidhje me programin e zhvillimit ekonomik të rishikuar për vitin 2018 për këtë shoqëri.

Ndër 450 punonjësit e Albpetrol sh.a., të cilët janë larguar nga puna, nëpërmjet pushimit kolektiv, ka individë, të cilët jo domosdoshmërisht kanë bindjet politike të ankuesit. Nga verifikimet e tjera, të kryera në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankese rezulton se nga 4 (katër) specialistë të Njësisë së Prokurimeve, pranë Q.F.M.T Patos, që iu nënshtruan vlerësimit me pikëzim nga Komisioni përkatës, njëri prej specialistëve të kualifikuar, që u përjashtua nga pushimi kolektiv, përkatësisht Znj. V.M. rezulton të ketë qenë pjesë e listës shumë emërore për këshilltarë të forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim, për Bashkinë Patos, të rrethit Fier, në zgjedhjet vendore të vitit 2011. Në seancën dëgjimore të datës 04.10.2018, përfaqësuesit e Albpetrol sh.a. e theksuan faktin se Znj. V.M është anëtare e LSI e pavarësisht kësaj, ajo vazhdon të punojë edhe pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë dhe nuk i është nënshtruar pushimit kolektiv, sikurse shumë punonjës të tjerë, që mund të kenë qenë edhe anëtarë apo simpatizantë të Partisë Socialiste.

Në provat e depozituara nga Albpetrol sh.a. rezulton se ka patur ankesa të simpatizantëve apo anëtarëve të forcës politike Partia Socialiste e Shqipërisë, të cilët i janë nënshtruar pushimit kolektiv, sikurse edhe ata punonjës, që janë anëtarë dhe aktivistë të forcës politike LSI. Në këtë kontekst, përmendim ankesën nr. 8441, datë 06.09.2018, e Z. A. K., i cili është anëtar i PS; ankesën nr. 9654, datë 05.10.2018, të Z. A.L., simpatizant dhe kontribues i Partisë Socialiste, i cili sërisht është larguar nga puna, në kuadër të zbatimit të ristrukturimit, si dhe ankesa nr. 8615, datë 10.09.2018, e Z. B. K., i cili sërisht ankohet se është larguar nga puna edhe se është simpatizant i PS.

Faktet dhe provat e sipërpërmendura vërtetojnë të kundërtën e pretendimeve të Z. K. B. dhe Komisioneri gjykon se largimi i tij nga puna, në kuadër të zbatimit të ristrukturimit të Albpetrol sh.a., nuk është bërë për shkaqe politike.

A. Viktimizimi i ankuesit K. B. nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a.

Ankesa e Z. K. B. është depozituar dhe regjistruar për shqyrtim pranë Komisionerit, në datën 09.07.2018. Gjatë kohës që ankesa nr. 100, datë 09.07.2018, e Z. K. B. ka qenë për shqyrtim pranë KMD-së, me anë të shkresës nr.6339, datë 20.07.2018, Albpetrol sh.a. e njofton Z. K. B., mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv. Pas marrjes dijeni për këtë fakt, Komisioneri e njofton zyrtarisht¹² Albpetrol sh.a., që në referencë të nenit 15, pika 2, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, marrëdhëniet e punës me ankuesin nuk duhet të ndërpritëshin, për sa kohë që ankesa e këtij të fundit ishte duke u shqyrtuar pranë KMD-së. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. dërgon zyrtarisht¹³ konfirmimin e saj që një gjë e tillë nuk do të ndodhë. Pavarësisht sa më sipër, ndërkohë që Komisioneri ishte në shqyrtim e sipër të ankesës së Z. K. B., Albpetrol sh.a. i dërgon ankuesit Vendimin nr. 730, datë 01.10.2018 “*Mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit organizativ*”, duke kundërshtuar në këtë mënyrë haptazi dispozitat ligjore.

Neni 3, pika 8, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon shprehimisht: “*Viktimizimi*” është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimesi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë.”

Mbështetur në sa më sipër, si dhe duke gjykuar mbi mënyrën se si është kryer procesi i vlerësimit më pikëzimit ndërmjet 4 (katër) specialistëve në Sektorin e Prokurimeve pranë Q.F.M.T. Patos, krijon bindjen e Komisionerit, për viktimizimin e ankuesit K. B., nga Albpetrol sh.a., si pasojë e ankimit të tij pranë KMD. Në këtë arsyetim, Komisioneri mbajti parasysh faktin se gjatë vlerësimit me pikëzimit të 4 (katër) specialistëve të sipërpërmendur, ata rezultuan me pikë të barabarta. Në vijim, sikurse është përmendur në rubrikën C/2, Komisioni i Vlerësimit ka marrë në konsideratë si kriter vlerësimi të mëtejshëm performancën e tyre në punë, nëpërmjet së cilës ka seleksionuar apo përzgjedhur 2 (dy) specialistët që do t’i nënshtroheshin pushimit kolektiv, njëri prej të cilëve ishte Z. K. B.. Kriteri i performancës rezultoi një kriter fiktiv, pasi Albpetrol sh.a. nuk ka kryer asnjëherë vlerësim të performancës në punë të punonjësve të tij, por në kushtet, kur njëri prej 2 (dy) specialistëve që u mbajt në punë, ishte anëtar i forcës politike LSI, u përjashtua mundësia e ekzistencës së diskriminimit të ankuesit për bindjet e tij politike.

¹² Referuar shkresës nr. 936/2, datë 31.07.2018, të KMD-së drejtuar Albpetrol sh.a.

¹³ Referuar shkresës nr. 963/5, datë 20.08.2018, të Albpetrol sh.a.

Por, në momentin, kur rezultoi se gjatë procesit të pushimit kolektiv, ankuesi ishte trajtuar në mënyrë të pabarabartë, si me kolegët e përzgjedhur për të qendruar në punë, ashtu edhe me kolegun e tij, Z. K. C., i cili sikurse Z. K. B., fillimisht iu nënshtrua pushimit kolektiv, e në vijim procedura e pushimit nga puna u ndërpre dhe ai u sistemua sërish në punë pranë Albpetrol sh.a.), Komisioneri, mbështetur në dyshimin e arsyeshem të krijuar nga këto fakte, përforcon bindjen e tij, që ankuesi është viktimizuar nga Albpetrol sh.a., për shkak të ankimimit të tij pranë KMD-së.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 17 dhe nenin 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 3, pika 1, nenin 7, pika 1, nenet 12-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “bindjes politike”, të Z. K. B., nga ana e Albpetrol sh.a., lidhur me uljen e tij në detyrë, nga pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve, në pozicionin e specialistit, pranë të njëjtit sektor, në Q.F.M.T. Patos.
2. Konstatimin e viktimizimit të Z. K. B., nga ana e Albpetrol sh.a., si pasojë e ankimimit të tij kundër kësaj shoqërie, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
3. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “bindjes politike”, të Z. K. B., nga ana e Albpetrol sh.a., lidhur me përfshirjen e ankuesit në pushimin kolektiv, të zbatuar nga kjo shoqëri.
4. Në referencë të pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Albpetrol sh.a., për sistemimin e ankuesit në një pozicion analog pune, me atë të Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve, pranë Q.F.M.T. Patos.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Albpetrol sh.a. të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – punesim
Shkak- bindja politike